



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 31 / 5 prot.

Tiranë më 22. 2.2018

VENDIM

Nr. 09, datë 22. 2.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Eco Albania me përfaqësues Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 31 Prot., datë 10.01.2018, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuessit, me shkresën e datës 16.11.2017 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm si më poshtë vijon:

1. Nëse Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive "Ayen Enerji" dhe "Fusha" shpk, ka paraqitur pranë institucionit tuaj studimin e fizibilitetit për HEC Kalivaç.
2. Nëse po, të na vihet në dispozicion studimi i fizibilitetit për HEC Kalivaç.

Duke qenë se nuk ka pasur asnjë reagim nga Autoriteti Publik, ankuesi ka përsëritur kërkesën me datë 11.12.2017.

Me shkresën nr. 1985/3 Prot., datë 20.12.2017, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: "Në zbatim të Ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" dhe akteve nënligjore për miratimin e rregullave dhe vlerësimin e dhënies me koncesion, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po kryen procedurat e vlerësimit dhe

negocimit të kontratës me bashkimin e shoqërive të sipërpërmendura. Duke e konsideruar konfidencial informacionin teknik të paraqitur nga subjekti fitues, një kopje e studimit të fizibilitetit do t'ju vihet në dispozicion vetëm në përfundim të procesit dhe nënshkrimit të kontratës, kundrejt pagesës së përcaktuar në urdhrin e Ministrisë të publikuar në websiten e MIE-s”.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 31 Prot., datë 10.01.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 32 datë 19.01.2018 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se me datë 16.11.2017 Eco Albania ka dërguar një kërkesë për informacion pranë Autoritetit Publik. Nga kartela shoqëruese e praktikës, e cila është sigluar nga Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit Publik vërehet se ajo i ka kaluar për trajtim Drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike, znj. Etleva Kondi. Pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik brenda afatit ligjor, Eco Albania ka ridërguar kërkesën për informacion me datë 11.12.2017. Nga kartela shoqëruese e praktikës vërehet se kjo shkresë pasi është sigluar nga Drejtori i Kabinetit, i ka kaluar sërish për trajtim Drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike. Me shkresën nr. 1985/3 Prot., datë 20.12.2017, i Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke e informuar se informacioni i kërkuar do t'vihet në dispozicion në momentin e përfundimit të procesit dhe nënshkrimit të kontratës. Këtë përgjigje Autoriteti Publik e ka argumentuar mbi bazën e konfidencialitetit që karakterizon informacionin teknik të paraqitur nga subjekti fitues.

Nga ana e saj koordinatorja për të drejtën e informimit sqaroi se është bërë me dije për rastin vetëm në momentin e depozitimit të urdhrin të inspektimit. Grupi i inspektimit kërkoi të kontaktojë me Drejtorin ose përfaqësues të Drejtorisë që sipas kartelave shoqëruese kanë trajtuar kërkesën e Eco Albania-s, por nuk u paraqit asnjë prej tyre.

Në vijim të inspektimit pranë Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 31/3 Prot., datë 02.02.2018, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore e cila u zhvillua me datë 08.02.2017. Në seancë u paraqitën pala ankuese dhe nga ana e Autoritetit Publik, koordinatorja për të drejtën e informimit, e cila sqaroi se: *Ftesa për seancë dëgjimore i ishte bashkëdeleguar për përfaqësim edhe Drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike, e cila, për arsye të një impenjimi tjetër nuk mundi të ishte e pranishme gjatë zhvillimit të seancës.* Seanca dëgjimore nuk u zhvillua më tej, pasi koordinatorja e Autoritetit Publik u shpreh se nuk kishte dijeni lidhur me rastin objekt ankese.

Me shkresën nr. 2228/1 Prot., datë 13.02.2018, Autoriteti Publik i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke mbajtur të njëjtin qëndrim, ashtu sikurse në përgjigjen e kthyer kërkuesit me shkresën nr. 1985/3 Prot., datë 20.12.2017.

Në shqyrtimin e çështjes, Zyra e Komisionerit i është referuar dhe dispozitave të Ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, (të referuar dhe nga Autoriteti Publik në përgjigjen e tij) i cili në nenin 15 të tij parashikon se: *"Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë konfidencialitetin, zbatohen edhe për koncesionet/partneritetet publike private të rregulluara me këtë ligj"*.

Neni 25 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, përcakton kufizime mbi Autoritetin Publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik, lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit deri në momentin e përfundimit të procesit dhe nënshkrimit të kontratës nuk rezulton i bazuar në ligj. Kjo për faktin se informacioni i cili konsiderohet konfidencial për shkak të karakterit të tij teknik, i tillë mbetet si gjatë, edhe pas përfundimit të procesit të nënshkrimit të kontratës midis Autoritetit Publik dhe subjektit fitues.

Për më tepër, bazuar në nenin 19 të Ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, si dhe nenin 13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat" i ndryshuar, hartimi i studimit të fizibilitetit (dokument që përbën objektin e kërkesës së ankuesit) është detyrë e autoritetit kontraktues, pra e Autoritetit Publik.

Pavarësisht sa më sipër, rezulton se, informacioni i kërkuar nga ankuesi pavarësisht nëse është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim quajtur "Ligji për të Drejtën e Informimit"), sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik"*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Për këtë arsye argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik rezulton i pabazuar në ligj dhe duke marrë parasysh sa është parashtruar më sipër, qëndrimi i Autoritetit Publik, pavarësisht përgjigjes së dhënë kërkuesit, në thelb përbën refuzim për dhënien e informacionit të kërkuar.

Në bazë të nenit 18, pika 2, gërma a) e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

Duke pasur parasysh faktin se informacioni i kërkuar mund të përmbajë të dhëna teknike të cilat mund të cilësohen si konfidenciale, Komisioneri vlerëson se kufizimet e pasqyruara nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe rrjedhimisht

refuzimi i dhënies së dokumentacionit është bërë në kundërshtim me pikën 6 të nenit 17, të Ligjit për të Drejtën e Informimit, i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Në këto kushte, personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të procedojnë me dhënien e informacionit/dokumentacionit duke respektuar referencat ligjore të cituara me sipër.

Sa i përket përgjegjësisë për mosdhënien e informacionit, siç rezultoi e provuar nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ, edhe pse Autoriteti Publik ka caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, lidhur me kërkesën për informacion të ankuesit, ky i fundit nuk është vënë në dijeni në asnjë moment për këto kërkesa dhe Sekretari i Përgjithshëm e ka kaluar për trajtim tek Drejtori i Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike, duke i veshur dhe kaluar në këtë mënyrë kësaj të fundit kompetencat e koordinorit për rastin konkret. Rrjedhimisht, vlerësohet se edhe përgjegjësia për mospërbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji për koordinatorin, i kalojnë personit të cilit i është veshur cilësia e koordinorit, dhe që në rastin konkret është Drejtori i Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike.

Në lidhje me ankimin e Eco Albania kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Eco Albania-s, nr. 31 datë 10.01.2018 ndaj autoritetit publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e autoritetit publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar lidhur me *studimin e fizibilitetit për HEC Kalivaç, sipas kërkesës për informacion të datës 11.12.2017, brenda datës 02.3.2018*
3. Dënimin e Drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike, Znj. Etleva Kondi me gjobë në vlerën 150.000 (një qind e pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 19, pika 3. Masa e dënimit me gjobë,

